

**Zana HOXHA**

Instituti Albanologjik  
Prishtinë

**KRONIKA SHKENCORE E AKTIVITETEVE TË  
INSTITUTIT ALBANOLOGJIK - DEGËS SË HISTORISË  
PËR VITIN 2024**

Kronika shkencore

Dega e Historisë pranë Institutit Albanologjik të Prishtinës gjatë vitit 2024 ka zhvilluar një sërë aktiviteteve shkencore të rëndësishme, duke kontribuar në studimin dhe promovimin e historisë shqiptare. Përmes konferencave, tryezave shkencore dhe promovimeve të librave, studiuesit kanë sjellë perspektiva të reja mbi çështjet historike dhe kulturore të Kosovës dhe më gjerë. Kjo kronikë përmbledh aktivitetet më të rëndësishme të zhvilluara nga kjo degë gjatë vitit.

**Konferenca dhe Tryezat shkencore**

**Tryeza shkencore: "Gjysmëshekulli Kushtetues i Kosovës  
(1974-2024)"**

Më 18 qershor 2024, Dega e Historisë e Institutit Albanologjik organizoi një tryezë shkencore me rastin e 50-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së vitit 1974. Tryeza, e cila u mbajt në ambientet e Institutit, u drejtua nga Mazllum Baraliu, Memli Krasniqi dhe Qerim Lita. Me kumtesa shkencore kontribuan studiuesit Mazllum Baraliu, Lulëzim Lajçi, Qerim Lita, Memli Krasniqi, Hasan Bello, Nuridin Ahmeti dhe Alban Dobruna.

### **Konferenca shkencore: "Lufta e Dytë e Kosovës (1448)"**

Në bashkëpunim me Komunën e Obiliqit-Kastriotit, Institutin e Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë dhe Institutin e Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, më 21 gusht 2024, në Sallën e Kuvendit Komunal të Obiliqit, u mbajt konferenca shkencore me titull "Lufta e Dytë e Kosovës (1448)". Në këtë konferencë u prezantuan kumtesa nga studiues si Lulëzim Lajçi, Iljaz Rexha, Etleva Lala, Muhamet Mala, Gjon Berisha, Besnik Rameti, Bashkim Lajçi, Agron Islami, Nutrika Lajçi, Teuta Shala-Peli, Muhamet Qerimi, Fidan Zeneli, Musa Ahmeti, Begzad Baliu, Nuridin Ahmeti, Kurt Bracob dhe Adem Zejnullahu. Konferenca u shoqërua me diskutime të gjera mbi rëndësinë historike të kësaj beteje.

### **Konferenca shkencore: Java e albanologjisë**

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Institutit Albanologjik të Prishtinës, për të pesëmbëdhjetin vit me radhë, u organizua Konferenca Shkencore "Java e Albanologjisë", e cila u mbajt nga data 9-11 shtator 2024. Një nga sesionet kryesore të kësaj konference ishte sesioni i Historisë me temën bosht "Xehetaria dhe minierat në Kosovë - Refleksione historike", i cili u zhvillua në dy seanca. Seancën e parë e drejtuan studiuesit Ardian Muhaj, Ylber Hysa dhe Mead Osmani. Pas fjalës hyrëse nga Prof. dr. Nuridin Ahmeti, shefi i Degës së Historisë, u prezantuan një sërë kumtesash nga studiues si Naser Ferri, Lulëzim Lajçi, Arianit Buqinca, Ylber Hysa, Ardian Muhaj, Bedri Muhadri, Musa Ahmeti, Qazim Namani, Agron Islami, Mead Osmani dhe Zana Hoxha. Seanca e dytë u drejtua nga studiuesit Armend Mehmeti, Qerim Lita dhe Sevdail Demiri. Në këtë seancë u paraqitën punime nga Zejni Mazllami, Armend Mehmeti, Arbër Hadri, Alban Dobruna, Qerim Lita, Sevdail Demiri, Nuridin Ahmeti, Shkodran Imeraj, Zekirja Shabani, Blerim Halili dhe Elza Shipoli. Fjalën përmbyllëse të këtij sesioni e mbajti studiuesja Zana Hoxha, e cila vlerësoi rëndësinë e hulumtimeve historike të paraqitura në këtë konferencë.

**Tryeza shkencore: "Lëvizjet parahistorike transhumant: Roli i tyre në shpërndarjen e të mirave dhe kulturës materiale përmes Alpeve"**

Më 5 tetor 2024, Dega e Historisë e Institutit Albanologjik organizoi një tryezë shkencore mbi lëvizjet parahistorike transhumante. Pas fjalës hyrëse nga Prof. dr. Nuridin Ahmeti, u mbajtën prezantime në gjuhën angleze nga studiues të njohur ndërkombëtarisht si Marie Besse, Maja Grguric, Michael Galaty, Albert Hafner dhe Arianit Buqinca.

**Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare**

Përveç organizimit të aktiviteteve shkencore brenda vendit, studiuesit e Degës së Historisë kanë qenë aktivë edhe në skenën ndërkombëtare, duke marrë pjesë në konferenca të rëndësishme jashtë Kosovës. Pjesëmarrja e tyre në konferenca ndërkombëtare ka mundësuar shkëmbimin e njohurive dhe përvojave me kolegë nga vende të ndryshme, si dhe prezantimin e rezultateve të kërkimeve shkencore.

**Nuridin Ahmeti:**

Seminari XVIII Ndërkombëtar i Albanologjisë "Kontributi i Rexhep Qosjes për letërsinë dhe kulturën shqiptar". Organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, më 25 shtator 2024, me kumtesën: "*Veprimtaria e profesor Rexhep Qosjes gjatë viteve 1968 - 1990 në dritën e disa dokumenteve arkivore të shtetit shqiptar*".

**Lulëzim Lajçi**

Konferenca shkencore ndërkombëtare "580-vjetori i Besëlidhjes së Lezhës", organizuar nga Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, më 2 mars 2024, me kumtesën: "*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*".

Konferenca shkencore ndërkombëtare "Neoshqiptarizmi – doktrinë vizionare për imazhin shqiptar dhe identitetin kombëtar në shekullin XXI", organizuar në kuadër të Festivalit XXI Ndërkombëtar "Imazhi Shqiptar", Tiranë, më 21 dhjetor

2024, me kumtesën: “Shtatë dekada përpjekje për studime albanologjike”.

### **Arianit Buqinca**

Konferenca shkencore e 30-të e Shoqatës Evropiane të Arkeologëve (EAA), organizuar në **Romë**, më **27-31 gusht 2024**, me kumtesën: “*The Traces of the Funerary Rite with Cinerary Urns in Tumular Necropolises in Kosovo and Northeastern Albania*”.

### **Zana Hoxha**

Konferenca shkencore e 30-të e Shoqatës Evropiane të Arkeologëve (EAA) organizuar në **Romë**, më **27-31 gusht 2024**, me kumtesën: “*Sacred Burial Structures during the Early Christian Period in the Territory of Kosovo*”.

Konferenca shkencore “**Figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe vise të tjera shqiptare**”, organizuar në **Preshevë**, më **26-27 tetor 2024**, me kumtesën: “*Fatmir Peja, Trashëgimia në Arkeologji, Numizmatikë dhe Epigrafi*”.

### **Elza Shipoli**

Konferenca shkencore e 30-të e Shoqatës Evropiane të Arkeologëve (EAA), organizuar në **Romë**, më **27 gusht - 1 shtator 2024**, me posterin: “*Late Antique Pottery Types, Characteristics: Case of Kosovo*”.

### **Zekirja Shabani**

Kongresi ndërkombëtar “**Munzur Scientific Research and Innovation Congress**”, organizuar në **Tunceli, Turqi**, më **6-7 gusht 2024**, me kumtesën: “*The Population of the Town of Vushtrri in the Mid-19th Century*”.

Konferenca shkencore ndërkombëtare “**Common Past—Divided Memories**”, organizuar në **Selanik, Greqi**, më **29 nëntor - 1 dhjetor 2024**, me kumtesën: “*The Ottoman Period in Kosovo: Interpretations of the Past and Contemporary Perspectives*”.

**Veprimtaria botuese**

Lush Culaj, *Ymer Berisha (1912-1946) një mision i pa kryer*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024.

Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi, *“Popullsia e Kazasë së Prizrenit sipas defterëve osmanë të vitit 1833 (Prizreni, Suhareka, Rahoveci, Malisheva, Drenasi)*, Insitituti Albanologjik, Prishtinë, 2024

Ylber Hysa, *Kotorri dhe Shqiptaret – nje nyje adritaikas e harruar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024.